

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

**Auditim**

**P6**

Data 08 korrik 2017

### **Detyra 1**

Sapo jeni kualifikuar si auditor i certifikuar dhe jeni përgjegjës në departamentin e auditimit të brendshëm të kompanisë OP, një kompani me rritje të shpejtë.

Qarkullimi i OP është rritur me 20% për vit, në pesë vitet e fundit në nivelin aktual prej €10 milion. Fitimet neto po ashtu janë të larta, më një kthim të pranueshëm në fitim për katër aksionarët e saj.

Departamenti i auditimit të brendshëm ishte themeluar vitin e kaluar për të ndihmuar bordin e drejtorëve në kontrollin e tyre ndaj kompanisë dhe për tu përgatitur për regjistrim të mundshëm në bursë.

Auditorët e jashtëm mund të kërkojnë të mbështeten në punën e kryer nga auditorët e brendshëm për shkak të efikasitetit të auditimit të jashtëm. Drejtori menaxhues është shumë i interesuar të ndjek parimet e qeverisjes së mirë të korporatave lidhur me auditimin e brendshëm. Mirëpo, ai po ashtu është i vetëdijshëm se anëtarët tjerë të bordit nuk kanë njohuri të plotë të qeverisjes së korporatës ose njohuri të detajuar të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit.

#### **Kërkohet:**

(a) Shkruani një memo për bordin e drejtorëve të PO e cila:

(i) Shpjegon se si departamenti i auditimit të brendshëm mund të ndihmojë bordin e drejtorëve në përmbushjen e obligimeve të tyre sipas parimeve të qeverisjes së mirë të korporatave. (8 pikë)

(ii) Shpjegoni dy përparësi dhe dy pengesa të komitetit të auditimit për PO. (4 pikë)

(b) Diskutoni çështjet që duhet të konsiderohen nga auditori i jashtëm në fazën e planifikimit të auditimit për të vlerësuar efektivitetin e departamentit të auditimit të brendshëm të një kompanie. (8 pikë)

**Total: 20 Pikë**

## Zgjidhja

**Nga: Auditori i brendshëm To: Board of IC**

**Tema: Roli i departamentit të auditimit të brendshëm**

**Data: korrik 20X7**

Fushat në të cilat Departamenti i auditimit të brendshëm mund të ndihmojë drejtorët në implementimin e qeverisjes së mirë korporative përfshin:

### **Raportet për bordin**

Rishikimi i raporteve për bordin dhe raportet e përpiluara nga bordi për të siguruar se ato me të vërtetët përfaqësojnë vlerësim të kuptueshëm dhe të balancuar të pozitës së kompanisë dhe të ardhmes. Departamenti do të ketë njohuri të mirë të aktiviteteve të kompanisë si dhe qasje në informata kontabël. Departamenti efektivisht mund të 'auditojë' raportet e bordit për të siguruar se ato janë të sakta dhe të kuptueshme.

### **Kontrollet e brendshme**

Bordi duhet të mirëmbajë sistem të shëndosh të kontrolleve të brendshme. Departamenti i auditimit të brendshëm do të jetë në gjendje të rishikojë kontrollet ekzistuese dhe të rekomandojë përmirësime për të siguruar se janë arritur objektivat.

### **Zbatimi i SNA dhe SNK**

Bordi duhet të ketë politika për zbatimin e duhur të SNA dhe SNK. Auditimi i brendshëm (sidomos kur auditorët janë të kualifikuar) do të jetë në dijeni për standardet e reja dhe kanë ekspertizën teknike për të identifikuar ndryshimet e kërkuara nga standardet e kontabilitetit. Prandaj mund të rekomnadohen ndryshime në sisteme për të zbatuar ndryshimet në standarde.

### **Komunikimi me auditorët e jashtëm**

Sipas rregullave të qeverisjes së korporatave, komunikimi me auditorët e jashtëm zakonisht bëhet përmes komitetit të auditimit, edhe pse bordi duhet të mbajë një marrëdhënie të përshtatshme me auditorët e jashtëm.

Mirëpo, auditorët e jashtëm dhe të brendshëm gjithashtu mund të punojnë së bashku për të siguruar se sistemi i kontrollit të brendshëm është i mjaftueshëm; kjo zakonisht arrihet kur auditorët e jashtëm mbështeten në punën e auditimit të brendshëm dhe duke e rishikuar punën e njëri tjetrit.

### **Komunikimi me bordin**

Auditori i brendshëm po ashtu mund të kontrollojë nëse është duke iu ofruar informata të duhura bordit nga auditorët e jashtëm. SNA 260 komunikimi i çështjeve të auditimit me personat e ngarkuar me qeverisjen ofron një listë të çështjeve të cilat duhet të komunikohen bordit nga auditorët e jashtëm. Prandaj auditorët e brendshëm mund të kontrollojnë nëse këto informata janë dërguar.

**(ii) Përparësitë e komitetit të auditimit**

### **Besimi publik**

Ofron një besim të shtuar publik për kredibilitetin dhe objektivitetin e informatave të publikuara financiare.

Kjo do të jetë veçanërisht e rëndësishme për mundësinë e listimit në bursë të kompanisë. Deri sa Departamenti i auditimit të brendshëm nuk është zakonisht i kërkuar për komanitë aksionare, ekzistenca e një Departamenti të tillë do të ofrojë besim shtesë për saktësinë e pasqyrave financiare dhe me shpresë do të tërheqë investime.

### **Raportimi financiar**

Mbështet drejtorët në përmbushjen e obligimeve të tyre për raportim financiar. Drejtorët duhet të përgatisin pasqyrat financiare për bordin. Komiteti i auditimit mund të kontrollojë nëse pasqyrat financiare janë në pajtueshmëri me kërkesat për raportim financiar. Kjo është e rëndësishme sidomos kur bordi nuk ka njohuri të detajuar për kërkesat e kontabilitetit dhe raportimit financiar.

### **Komunikimi**

Rritja e rolit të auditorëve jashtëm të kompanisë duke i ofruar kanal të përshtatshëm të komunikimit. Komiteti i auditimit do të mundësojë auditorët e jashtë të diskutojnë çështjet e pasqyrave financiare me auditorin e brendshëm, para se të ofrohen përmbledhjet finale të bordit.

### **'Mik' i bordit**

Komiteti i auditimit po ashtu mund të ketë rolin e 'mikut kritik' të bordit duke monitoruar punën e bordit dhe duke i ofruar udhëzime të dobishme, në rastet kur duket se kërkesat e qeverisjes së korporatës nuk përmbushen. Komitetit i auditimit duhet të ketë njohuri të detajuar të qeverisjes së korporatave si pjesë e funksionit monitories që ka dhe mund ta ndajnë këtë njohuri me bordin.

Pengesat e komitetit të auditimit

### **Mungesa e të kuptuarit të funksionit**

Pasi që drejtorët e kompanisë nuk kanë njohuri të mjaftueshme për qeverisjen e korporatës, ata mund të perceptojnë spërfshirjen e komitetit të auditimit si kërcënim ndaj autoritetit të tyre ose mendojnë se ju merr disa nga përgjegjësitë e tyre.

### **Roli i drejtorëve joekzekutiv**

Pasi që komitetit i auditimit përbëhet kryesisht nga drejtorët joekzekutiv, bordi mund ta shohë këtë si rënie e fuqisë të tyre. Përsëri, komiteti i auditimit duhet të shihet si organ që përmbush një rol mbështetës për bordin.

### **Kosto**

Komiteti i auditimit do të rrisë shpenzimet e kompanisë pasi që drejtorët joekzekutiv duhet të kompenzohen për punën e tyre.

**(b) Kriteret që duhet të konsiderohen:**

(i) Statusi organizativ

Statusi i departamentit të auditimit të brendshëm në një organizatë dhe efekti që ka në aftësinë për të qenë objektiv. Nëse klienti është një kompani e listuar, ata mund të kenë një komitet të auditimit. Nëse kjo është e vërtetë atëherë ky departament duhet ti raportojë komitetit të auditimit. Në praktikë është e mundur që pjesa më e madhe e departamentit të auditimit të kontrollohet nga drejtori financiar. Mirëpo, duhet të ketë input nga bordi për të siguruar se të gjitha aspektet e rëndësishme janë të mbuluara nga auditorët e brendshëm. Siç është theksuar më lart, auditimi i brendshëm duhet ta ketë të drjetën ti raportojë komitetit të auditimit, gjithashtu edhe të jenë të lirë të komunikojnë me auditorët e jashtëm. Pavarësia e departamentit të auditimit të brendshëm është e rëndësishme prandaj duhet të konsiderohet nëse auditorët e brendshëm kanë pavarësi të mjaftueshme për të kryer punën e tyre.

(ii) Objekti i funksionit

Auditori i jashtëm do të rishikoj se çfarë veprim ndërmer kompania si rezultat i punës së auditorëve të brendshëm. Duhet të ndërmerren veprime nga auditorët e brendshëm për të zbuluar mangësi domethënëse në sistemin e kontabilitetit ose gabime në përpunimin e transaksioneve. Auditorët e brendshëm duhet të ri-testojnë sistemet për të kontrolluar nëse janë korrigjuar problemet.

(iii) Kompetenca teknike

Auditori i jashtëm duhet të kontrollojë kualifikimet dhe përvojën e auditorëve të brendshëm. Nëse auditorët e brendshëm kanë kualifikim të duhur (psh janë anëtarë të ShKÇAK) atëherë puna e tyre ka mundësi të jetë më e besueshme.

Përvoja në auditim është e rëndësishme. Duhet të kontrollohet nëse auditorët e brendshëm kanë përvojë të mëparshme si dhe nëse ndjekin programin e vazhdueshëm profesional.

(iv) Kujdesi i duhur profesional

Puna e auditorëve të brendshëm duhet të planifikohet si duhet, të mbikqyret, rishikohet dhe dokumentohet. Auditori i jashtëm do të kontrollojë letrat e punës së auditorëve të brendshëm duke shikuar çfarë pune është kryer dhe nëse është e përshtatshme dhe nëse konkluzionet e arritura janë në pajtueshmëri me testet dhe evidencën e auditimit.

## Detyra 2

Ju jeni seniori i auditimit, përgjegjës në auditimin e kompanisë ProAMA. Për të ju ndihmuar në planifikimin e auditimit, njëri nga anëtarët e ekipit ju ka ofruar një përshkrim për sistemin e blerjeve, i paraqitur në vijim. Nuk ka kontrole tjera në këtë sistem përveç atyre të përshkruara më poshtë.

- Kompania nuk ka departament të blerjes prandaj punonjësit bëjnë porositë në fushën e tyre të përgjegjësisë. Përdoret një formë me tre pjesë; kopja 1 mbahet nga përpiluesi i porosisë; kopja 2 dërgohet në departamentin e pranimin të mallrave dhe kopja 3 dërgohet te furnitori.
- Mallrat pranohen mirëpo nuk kontrollohen nga nëpunësi i pranimin të mallrave. Nëpunësi i pranimin të mallrave e plotëson një formë të pranimin të mallrave dhe e dërgon atë te nëpunësi i librit të blerjeve.
- Kur pranohet fatura e furnitorit ajo dërgohet te nëpunësi i librit të blerjeve. Nëpunësi i librit të blerjeve kontrollon llogaritjen në faturë, e nënshkruan dhe ia bashkangjet formën e pranimin të mallit.
- Fatura pastaj dërgohet të menaxheri përgjegjës për punonjësin i cili ka porositur mallrat. Menaxheri ia vendos një kod faturës dhe e kthen te nëpunësi i librit të blerjeve.
- Faturat e blerjes regjistrohen në tabelën analitike nga nëpunësi i librit të blerjeve. Kjo postohet në bazë mujore në librin kryesor dhe në librin e blerjes nga nëpunësi i librit të blerjeve.
- Arkëtari paguan furnitorët në baza mujore pas udhëzimit nga nëpunësi i librit të blerjeve. Llogaria kontrolluese e librit të blerjeve harmonizohet në baza mujore nga nëpunësi i librit të blerjeve i cili po ashtu i harmonizon kartelat e furnitorëve me librin e blerjeve.

### Kërkohet:

(a) Analizoni mangësitë kyçe në kontrollin e brendshëm në sistemin e blerjeve siç është paraqitur më sipër. (7 Pikë)

(b) Shpjegoni llojet e gabimeve që mund të rezultojnë nga secila mangësi e identifikuar. (7 pikë)

(c) Vlerësoni ndikimin e secilës mangësi në procedurat normale të auditimit duke konsideruar procedurat shtesë të auditimit. (6 pikë)

**[Total: 20 Pikë]**

## Zgjidhja

<p><b>Mangësia</b></p> <p><i>Porositja e mallrave</i> Nuk kërkohet autorizim që punonjësit të porosisin mallra. Format e porosisë nuk dërgohen tek personi përgjegjës për autorizim. Format e porosisë nuk janë të paranimuara Nuk ka dëshmi se ekziston lista e autorizuar e furnitorëve.</p>	<p><b>Ndikimi në auditim</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk ka kontroll qëndror për nivelet e riporostijes prandaj mund të humbet efikasiteti i biznesit. Përveç kësaj kompania nuk mund të merr çmimin më të mirë.</li> <li>• Vështirë të kontrollohet se të gjitha mallrat e porositura janë për qëllim të biznesit.</li> <li>• Vështirë të kontrollohet nëse të gjitha detyrimet janë regjistruar, si rezultat detyrimet mund të jenë nënvlerësuar.</li> </ul>
<p><i>Pranimi i mallrave</i> Nuk ka kontrollim fizik të mallrave të pranuar dhe krahasim me fletëporosinë dhe me fletëpranimet. Nuk ka krahasim të fletëpranimit dhe fletëporosinë. Nëpunësi i pranimit të mallrave i mban të dy kopjet, fletëpranimin dhe fletëporosinë që i jep mundësinë të bëjë ndryshime të paautorizuara në formë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Cilësia e mallrave të pranuar mund të mos jetë e kënaqshme dhe si pasojë detyrimet dhe stoqet mund të mbivlerësohen.</li> <li>• Detyrimet mund të mbivlerësohen nëse mallrat e pranuar janë më pak se në fletëpranim.</li> <li>• Efekti në stoqe në fund të vitit për mallrat në mungesë varet se si bëet numërimi i stoqeve në fund të vitit. Mirëpo blerjet mund të jenë të mbivlerësuar.</li> </ul>
<p><i>Pranimi i faturës</i> Nuk ka kontrolle për të përputhur sasitë e faturuara me ato të porositura si dhe nuk ka kontroll të cilësisë së mallrave</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Blerjet dhe detyrimet mund të kenë anomali, nëse faturat nuk janë të sakta.</li> </ul>
<p><i>Autorizimi</i> Nuk ka dëshmi të besueshme për të siguruar se të gjitha faturat autorizohen nga menaxhmenti. Nuk ka procedura për të siguruar se faturat ruhen sigurt dhe për faturat që kthehen.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbivlerësim i mundshëm i blerjeve dhe detyrimeve nga faturat të cilat nuk janë përcjellur për autorizim nga personi që porosit mallrat.</li> <li>• Humbja e faturave në transit mund të ndodhë dhe kështu detyrimet mund të nënvlerësohen dhe kjo të mos identifikohet deri sa bëhet harmonizimi i llogarisë kontrolluese të librit të blerjeve.</li> <li>• Humbja e faturave do të thotë humbje e dokumentacionit që rezulton me humbje të gjurmës së auditimit.</li> </ul>
<p><i>Regjistrimi</i> Nuk ka ndarje të detyrave në mes të funksionit të regjistrimit në librin kryesor dhe librin e blerjeve. Nuk ka kontrolle aritmetikore kur regjistrohen faturat e blerjes.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Moskorrigjimi i gabimeve në blerje të regjistruara</li> </ul>
<p><i>Pagesat për furnitorët dhe harmonizimi</i> Nuk ka ndarje të detyrave në asnjërin prej funksioneve. Edhe pse akëtari paguar furnitorët, ai e bënë këtë vetëm pas urdhërit nga nëpunësi i librit të blerjeve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përsëri, vlefshmëria e blerjeve, stoqeve dhe saldoeve të llogarive të pagueshme në pasqyrat financiare mund të vihet në pyetje.</li> </ul>
<p><i>Të përgjithshme</i> Kur një mangësi ka ndikim në biznes por nuk ka ndikim në pasqyra financiare, auditori</p>	

ende duhet të konsideroj raportimin e çështjes në letrën e menaxhmentit.	
--	--

### **(c) Procedurat shtesë të auditimit**

Duke konsideruar mangësitë e identifikuara më sipaër, nuk mind të ketë mbështetje mbi sistemin e blerjeve, prandaj auditori duhet të kryj procedura të plota ta pavarura.

Theksi i testeve të pavarura do të ishte në zbulimin e gabimeve të mundshme të identifikuara më sipër, dmth

- nënvlerësimi ose mbivlerësimi i blerjeve dhe detyrimeve
- anomalitë në stoqe

#### **1. Mbivlerësimi i blerjeve dhe detyrimeve**

- Procedurat analitike në secilën fushë për të identifikuar shpenzimet në tepricë.
- Testim i zgjeruar në fushat 'me rrezik të lart' të identifikuara më sipër.
- Rishikim i kujdesshëm i detajeve të farurave dhe fletporosive dhe fletpranimeve
- Rishikim i fletporosive dhe fletpranimeve për të kërkuar dëshmi të fshirjes ose ndryshimit të të dhënave.
- Kontrollimi i porosive të blerjes dhe fletpranimeve për furnitorët e njohur.

#### **2. Testimi i prerjes**

- Harmonizimi i fletporosive të fundit vitit që mbahen nga të punësuarit me fletporosit dhe fletpranimet që mbahen te nëpunësi i librit të blerjeve.
- Harmonizimi i fletpranimeve, stoqet e pranuar me faturën dhe librin e blerjeve.
- Harmonizimi i pagesave pas fundit të vitit me faturat përkatëse dhe me fletpranimet pqr të siguruar se blerjet janë regjistruar në periudhën e duhur.
- Rishikimi i faturave pas fundit të vitit për të verifikuar a ka detyrime të paregjistruara para fundit të vitit.

#### **3. Anomalitë në stoqe**

- Kontrollimi i sasive të stoqeve gjatë numërimit të stoqeve në fund të vitit me theks të veçantë në mbivlerësim.
- Rishikimi i mallrave për të kërkuar artikuj të dëmtuar dhe për tu siguruar se janë bërë korrigjime të duhura në libra.
- Testim i zgjeruar i shitjeve pas fundit të vitit për të zbuluar nëse stoqet duhet të sjellen në vlerën neto të realizueshme.
- Përputhja e pagesave me para me librin e blerjeve dhe dokumentet mbështetëse.
- Rishikimi i dhe përputhja e harmonizimeve mujore.
- Konfirmimi i llogarive të pagueshme për të harmonizuar me fund-vit.

### Detyra 3

Kiko është një kompani që disenjon dhe mirëmban faqe të internetit për një gamë të gjërë të organizatave dhe operon në regjionin e Ferizajit. Kiko zotërohet nga dy ndërmarrës, Bamiri dhe Iliri. Të dy kanë përvojë në këtë sektor dhe kompania e tyre është në treg që 5 vite.

Kiko është duke u rritur në mënyrë të shpejtë në terma të:

- Numrit të klientëve
- Numrit të personelit të punësuar
- Fitimeve

Tani është 13 dhjetor 2016 dhe juve ju kanë kontaktuar për të kryer auditimin e Kiko për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2016.

Firma juaj, që është firma më e madhe e auditimit në regjionin e Ferizajit, nuk e ka audituar këtë kompani më herët. Kiko ka pasur tre kompani të ndryshme të auditimit që nga fillimi.

Në takimin e fundit me të dy drejtorët, Iliri ju ka shpalosur juve si menaxher i auditimit, arsyeet pse Kiko dëshiron të ndryshoj auditorin. Arsyeja e ndryshimit të auditorit është për shkak të mosmarrëveshjeve lidhur me disa shpalosje në pasqyrat financiare të vitit të kaluar. Drejtorët konsiderojnë se mosmarrëveshja është çështje tepër e vogël dhe kanë treguar se kontabilisti i kompanisë është në gjendje të ofrojë hollësitë e çështjes pasi që të filloj auditimi. Ju i keni shpjeguar se para pranimit të angazhimit të auditimit janë disa çështje që duhet të konsiderohen nga firma juaj dhe disa procedura që duhet të kryhen, disa prej të cilave kërkojnë bashkëpunimin e drejtorëve. Firma juaj ka klient të tjerë të cilët operojnë në sektorin e njejtë të shërbimeve të faqeve të internetit. Drejtorët kanë kërkuar nga ju të filloni me auditimin menjëherë pasi që pasqyrat financiare të audituara ju nevojiten deri me datën 31 janar 2017. Firma juaj është shumë e zënë me punë në këtë periudhë të vitit.

#### Kërkohet:

(a) Diskutoni çështjet që duhet të konsiderohen dhe procedurat që duhet të kryhen para pranimit të angazhimit si auditor të Kiko. (10 pikë)

(b) Pse do të ishte e papërshtatshme të fillohet me auditimin para konsiderimit të çështjeve dhe procedurave të kryera të referuara nën (a) më sipër? (5 pikë)

(c) Identifikoni dhe shpjegoni PESË parimet kryesore të kodit të etikës së IFAC. (5 pikë)

[Total: 20 Pikë]



## Zgjidhja

### Solution

#### (a) Çështjet e brendshme dhe procedurat tjera para angazhimit

Firma duhet të konsideroj një gamë të çështjeve komerciale dhe etike

*Çështjet e brendshme*

Para pranimit të angazhimit firma duhet të sigurojë se:

- (i) ka personelin e domosdoshëm me kompetenca të përshtatshme për të përfunduar auditimin (kjo duket se është e duhur pasi që firma ka përvojë në klient të ngjashëm);
- (ii) personeli është në dispozicion në një kohë që është shumë e ngarkuar për firmën e auditimit;
- (iii) firma është e pavarur nga Kiko. Nuk ka shumë mundësi që firma të ketë ndonjë pronësi të klienti pasi që klienti zotërohet nga dy pronar, por duhet të shihet nëse ka palë të lidhura me stafi i firmës; may be staff or partners who are related to the client or are otherwise connected with it;
- (iv) nuk ka konflikte të interesit të cilat nuk mund të menaxhohen si duhet. Konflikti i interesit mund të paraqitet për faktin se firma e auditimit ka klient të tjera në sektorin e njëjtë.

Procedurat tjera

Firma duhet të:

- (v) kërkojë miratim nga drejtorët të komunikojë me kontabilistin e kompanisë për të diskutuar natyrën e 'mosmarrëveshjes' dhe drejtorët duhet ta lejojnë kontabilistin të bashkëpunojë me auditorët;
- (vi) kërkojë nga drejtorët të miratojë komunikimin me auditorët paraardhës. Nëse ky miratim nuk jepet, angazhimi duhet të refuzohet;
- (vii) kërkojë nga klienti të shkruaj auditorit paraardhës për vendimin për të ndryshuar auditorin dhe për të dhënë mundësi auditorit të kaluar të komunikojë me firmën e tanishme. Nëse ky miratim nuk jepet, angazhimi duhet të refuzohet;
- (viii) komunikojë me auditorët paraardhës (me shkrim) për të kërkuar informata të rëndësishme për të vendosur nëse firma mund të pranojë angazhimin;
- (ix) kërkojë transfer të përshtatshëm të informatave (siç janë kopjet e pasqyrave financiare të fundit dhe bilancin vërtetues për të harmonizuar me pasqyrat financiare);
- (x) paraqes tarifën e angazhimit dhe të sigurohet se kjo është e pranueshme për klientin dhe nëse klienti ka aftësi të paguaj.

#### (b) Fillimi i auditimit

Nuk është e përshtatshme të filloj auditimi pa u kryer procedurat e mësipërme sepse:

- (i) pa personel të duhur dhe kompetent firma do të shkelte rregulloret e auditimit dhe mund të paditej për neglizhencë nga rregullatorët e auditimit nëse gjërat mund të shkojnë keq
- (ii) pa pajtueshmëri me kërkesat për pavarësi dhe konflikt të interesit, firma e auditimit mund të mos jetë objektive në kryerjen e angazhimit;
- (iii) pa i kryer procedurat e duhura firma nuk mund të jep opinion mbi integritetin e klientit e cila mund të përfshihet në akvite të paligjshme;);
- (iv) pa u pajtuar për tarifën e auditimit mund të lindin keqkuptime dhe mosmarrëveshje;
- (v) pa komunikim me kontabilistin dhe me auditorin paraardhës, ka mundësi që të paraqitet përsëri mosmarrëveshja lidhur me shpalljen ngjashëm sikur vitin e kaluar;

#### (c) Parimet themelore të kodit të etikës

Integriteti – të jesh i drejtpërdrejt dhe i ndershëm në të gjitha marrëdhëniet biznesore dhe profesionale.

Objektiviteti – mos lejimi i anësisë, konfliktit të interesit ose influencës së tepruar të të tjerëve për të anashkaluar gjykimet profesionale ose biznesore.

Kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur – mbajtja e njohurisë profesionale dhe aftësisë të kërkuara për të siguruar se klienti pranon shërbime profesionale dhe të vepruarit me kujdes dhe në pajtueshmëri me standardet teknike dhe profesionale.

Konfidencialiteti – ruajtja e informatave konfidenciale të pranuar si rezultat i marrëdhënies profesionale ose biznesore, dhe mosshpalosja e këtyre informatave tek palët e treta pa një autorizim praparak, e as përdorimi i këtyre informatave për avantazh personal.

Sjellja profesionale – pajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret dhe shmangia e çfardo veprimi që diskrediton profesionin.

#### Detyra 4

Ekzaminimi i evidencave është fundamentale në procesin e auditimit. SNA 500 *Evidencat në Auditim* thekson se qëllimi i auditorëve është “*të disenjoj dhe kryej procedura në mënyrë të tillë që t’i mundësojë auditorit të përftojë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për të arritur në konkluzione mbi të cilat bazohet opinioni i auditorit*”. Auditori gjithashtu duhet të kryejë procedura shtesë kur evidencat janë të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme në atë fushë të caktuar të auditimit.

Nga menaxheri i auditimit u është kërkuar të testoni gjendjen/saldon e llogarive të pagueshme të kompanisë Tregu Shpk për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2016. Gjendja e llogarive të pagueshme, edhe pse është materiale, është konsideruar si fushë me rrezik të ulët të auditimit në fazën e planifikimit. Ju tashmë keni kryer disa procedura analitike të auditimit dhe keni identifikuar se ditët në llogaritë e pagueshme janë siç vijon:

**31 dhjetor 2016**

15 ditë

**31 dhjetor 2015**

40 ditë

**31 dhjetor 2014**

42 ditë

#### Kërkohet:

- (a) Shpjegoni çka nënkuptohet nga evidencë e “mjaftueshme” dhe e “përshtatshme” e auditimit. (3 pikë)
- (b) Nga puna juaj deri me tani në kompaninë Tregu, identifikoni shkaqet e mundshme që kanë ndikuar në rënien në ditët e të pagueshmeve dhe ndikimin që mund të ketë kjo në auditimin e llogarive të pagueshme. (5 pikë)
- (c) Cilat evidenca shtesë do të ju nevojiten për tu siguruar se evidenca e grumbulluar lidhur me llogaritë e pagueshme është e mjaftueshme dhe e përshtatshme? (12 pikë)

**[Total: 20 pikë]**

## Zgjidhja

**(a)** Mjaftueshmëria është masë e sasisë së evidencave të auditimit. Përshtatshmëria është masë e cilësisë së evidencave të auditimit; që do të thotë evidence është relevante dhe e besueshme për të ofruar mbështetje ose për të ndihmuar në zbulimin e anomalive në klasë të transaksioneve, saldo të llogarive dhe në shpalosje të pasqyrave.

Sasia e evidencave të auditimit ndikohet nga rreziku e anomalisë – sa më i madh rreziku më shumë evidence kërkohen, por gjithashtu edhe cilësia e evidencave – sa më cilësore, më pak mund të kërkohet.

Prandaj përshtatshmëria dhe mjaftueshmëria janë të lidhura në mes vete.

**(b)** Shkaqet e mundshme për rënie në ditë të të pagueshmeve në kompanië janë:

- Pagesat bëhen më shpejtë. Psh shpejtësia e dërgëve.
- Pagesa në avans për të fituar zbritje ose për të shmangur pagesa të gjobave dhe interesit.
- Ndryshime në kushte të blerjeve me kredi që ofrohen nga furnitorët për të shpejtuar pranimin e parasë.
- Regjistrime domethënëse në librin e të pagueshmeve mund të jenë për shkak të gabimeve në postim.
- Blerjet e mbivlerësuara në KMSH psh për shkak të problemeve me prerjen ose me pohimin e ndodhjes etj.
- Detyrime të nënvlerësuara për shkak të çështjeve me prerjen e blerjeve ose të pagueshme të paplota, etj.

Implikimet me auditim kryesisht mund të jenë për shkak të detyrimeve të nënvlerësuara ose blerjeve të mbivlerësuara. Në atë rast rreziku i vlerësuar duhet të rishikohet dhe të kryhen teste të mëtutjeshme të pavarura sidomos për pohimin e prerjes dhe të vlerësimit dhe ndodhjes. Nëse këto ndryshime janë normale duhet të rishikohen kushtet kontratave me furnitorët etj.

**(c)** Nëse rreziku është rishikuar dhe si pasojë është rritur si rezultat i procedurave analitike të identifikuar më sipër, atëherë duhet të kryhen procedura shtesë të pavarura për të siguruar se auditori ga grumbulluar evidence të mjaftueshme.

Procedurat shtesë mund të përfshijnë

- Testimin e llogarisë kontrolluese të të pagueshmeve, përputhja e saldove fillestare, kryerja e veprimeve matematikore etj.

Plotësia dhe ndodhja

- Përputhja e saldove nga llogaria kontrolluese me pasqyrat financiare - plotësia
  - Marrja e një liste të të pagueshmeve, mbledhja e listes dhe krahasimi me llogarinë kontrolluese – ndodhja
  - Për një mostër të të pagueshmeve nga lista, përputhja me harmonizmin e kartelave të furnitorëve. Sigurimi se metoda e përzgjedhjes së mostrës nuk i lë anash llogaritë me sado zero ose të vogëla - ekzistenca
  - Rishikimi i porosive të pakryera dhe faturave për detyrime të paregjistruara - plotësia
  - Rishikimi i pagesave pas fundit të vitit për detyrime të paregjistruara – plotësia
  - testimi i prerjes duke kontrolluar llogaritë e pagueshme, blerjet dhe stoqet duke kontrolluar dokumentet e pranimin para dhe pas fundit të vitit – plotësia dhe prerja
  - Rritja e testimit të transaksioneve të blerjes sidomos për ndodhje dhe plotësi
  - Rishikimi i sadoleve debitorë në librin e blerjeve dhe pyetni menaxhmentin për arsyet.
- Riklasifikoni pasi që mund të jenë pagesa në avans – plotësia dhe kllasifikimi
- për ndryshimet në kushtet të blerjeve me kredi, pyetni menaxhmentin për arsyen dhe kontrolloni autorizimet në dokumentet

## Detyra 5

(a) Firma juaj e auditimit tash së voni ka fituar një tender për auditimin e një klienti shumë interesant, Huma Shpk. Huma ofron trajnime në lidhshm, planifikim funksional dhe një gamë të gjërë të shërbimeve për tregun e korporatave. Nga ju është kërkuar të përpiloni një letër të angazhimit.

### Kërkohet:

Përshkruani çështjet që zakonisht përfshihen në një letër të angazhimit. (5 pikë)

(b) Duke shikuar dosjen e klientit të ardhshëm (Huma Shpk më sipër) dhe dokumentet e tenderit ju keni hasur në disa çështje të cilat besoni se mund të ndikojnë në këtë auditim.

- Njëri nga partnerët e konsulencës në firmën tuaj është duke kryer punë të konsulencës menaxheriale tek ky klient dhe kjo punë përfshinë edhe parashikimet dhe konsulencën lidhur me modelin e rritjes së biznesit për Huma Shpk.
- Firma juaj ka përdorur më herët shërbimet e Huma Shpk për trajnime dhe gjithashtu ka promovuar në mënyrë aktive shërbimet e kësaj firme te klientët e saj.
- Tarifa e propozuar e auditimit për këtë angazhim është dukshëm më e lart se tarifa e auditorit të mëparshëm dhe ka disa shqetësime pse firma e juaj ka qenë e suksesshme në këtë tender.
- Auditorët në firmën tuaj kanë pak përvojë në sektorin në të cilin operon Huma, pjesa më e madhe e ekspertizës është në pjesën e konsulencës menaxheriale të firmës tuaj.

Përveç kësaj, auditimi duhet të kryhet në periudhën më të ngarkuar të vitit dhe afatet kohore për raportim të Huma janë shumë të ngushta me pak gjasa për shtyerje. Kjo është për shkak të kredive bankare që ka kompani në disa nga bankat e mëdha të vendit të cilat kërkojnë pasqyrat financiare të audituara brenda tre muajsh pas përfundimit të vitit.

### Këkohet:

Lidhur me çështjet shqetësuese më sipër, diskutoni se si mund të ndikojnë ato në auditim dhe nëse shkelin standardet etike të auditorit dhe identifikoni masat mbrojtëse që mund të zbatohen nga firma e auditimit për të siguruar se firma është e pavarur dhe nuk ka kërcënime për etikën.

(15 pikë)

[Total: 20 pikë]

## Zgjidhja

### (a) Elementet e letrës së angazhimit

Kushtet e angazhimit për auditim zakonisht paraqiten në letrën e angazhimit e cila është në formë të shkura dhe mund të përfshijë:

- o Qëllimin dhe objektin e auditimit të pasqyrave financiare;
- o Përgjegjësitë e auditorit;
- o Përgjegjësitë e menaxhmentit;
- o Identifikimin e kornizës së zbatueshme të raportimit financiar për përgatitjen e pasqyrave financiare; dhe
- o Referencë për raportet e pritshme që do të lëshohen nga auditori dhe deklaratën se mund të ketë rrethana që raporti mund të jetë i ndryshëm nga ajo që pret menaxhmenti.
- o Pikë tjera mund të përfshijnë: bazën për tarifa, përdorimin e ekspertëve, etj

### (b) Qështjet për shqetësim

(i) Lidhur me ofrimin e shërbimeve tjera – standardet etike lejojnë ofrimin e shërbimeve të tilla për klientët e auditimit. Pavarësia e auditorit nuk do të ishte çështje për shkak se roli i auditorit ka natyrën e konsulencës. Auditori, megjithatë duhet të kujdeset që të mos merr rolin e përonit përgjegjës në kompani dhe të mos merr vendime menaxheriale. Në këtë rast partneri i angazhuar nuk duhet të jetë partner i auditimit. Për tu mbrojtur nga ndonjë kërcënim i mundshëm, firma duhet të sigurohet sepërdoret personel i veçantë në auditim dhe shërbie tjera. Gjithashtu, puna e personelit të auditimit duhet të rishikohet me kujdes. he öork and fees should be revieeed to ensure there is not undue dependence on this client.

(ii) Përdorimi i shërbimeve nga klienti. Duhet të rishikohet nëse shërbimet e pranuar nga klienti janë në vlerën e drejtë dhe gjatësinë e krahut. Mirëpo në anën tjetër mund të shihet se ka kërcënim të avokimit për shkak të promovimit të klientit. Një masë mbrojtëse do të ishte që firma e auditimit të shmang promovimin e klientit të saj, për të zvogëluar kërcënimin e pavarësisë në dukje.

(iii) Për derisa partneri është i kënaqur me tarifën që është ofertuar dhe se ajo mbulon kohën dhe nivelin e personelit të përfshirë në këtë angazhim, nuk ka ndonjë kërcënim të pavarësisë ose shkelje të parimeve të etikës. Mirëpo, mund të ketë shqetësime pse firma jonë është zgjedhur të auditoj klientin, mund të ndihodhë që klienti është duke bërë pazar për opinion prandaj duhet të ndërmarrim masa mbrojtëse. Kjo arrihet përmes kryerjes së punës sipas standardeve, duke kontrolluar cilësinë e punë dhe duke grumbulluar evidence të mjaftueshme dhe të përshtatshme për ta mbështetur opinion e dhënë.

(iv) Nuk shkel standardet e etikës sepse nuk është një fushë me rrezik të madh se që kërkon ekspertizë të specializuar, por duhet të sigurojmë cilësinë e punës së kryer.

(v) Pika e fundit ka të bëjë me kohën e kryerjes së auditimit por gjithashtu mund të hedh dyshim mbi aftësinë e kompanisë për të vijuar operacionet. Duhet të sigurohemi se puna mbikqyret dhe rishikohet nga niveli i duhur i auditorëve. Gjithashtu duhet të sigurohemi se nuk kalojmë ndonjë procedurë të auditimit për të shkurtuar kohën e auditimit. Çështjet me hipotezën e vijimësisë duhet të rishikohen në fazën e planifikimit dhe të kontrollohet gjatë gjithë auditimit.